VENDIM
Nr. 841, datë 14.10.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 953, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË LIGJIT NR. 92/2014, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 56 e 159, të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Në nenin 8 bëhen shtesat e mëposhtme:

Në fund të pikave 4.1, 4.2 dhe 4.3 shtohet shkronja "ë", me këtë përmbajtje:

"ë) Deklaratë e personit të tatueshëm që makineria apo pajisja, për të cilën kërkohet përjashtimi, nuk është importuar për qëllime shitjeje.".

Pas shkronjës "ç", të pikës 4.4, shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) Deklaratë e personit të tatueshëm që makineria apo pajisja, për të cilën kërkohet përjashtimi, nuk është importuar për qëllime shitjeje.".

Në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, hiqen kodet e mëposhtme:

8421 23 00 - - Filtrat e vajit ose naftës për motorët me djegie të brendshme;
8421 29 00 - -Të tjera;
8421 31 00 - - Filtrat e marrjes së ajrit për motorët me djegie të brendshme;
8414 20 80 - - Pompa dore për mjete të llojit biçikleta, motoçikleta, tricikla;
8414 20 80 - - Të tjera;
8438 80 10 - - Për përgatitjen e çajit apo të kafesë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama